

RRETH PËRKTHIMIT TË KURANIT NË GJUHËN SHQIPE**ABOUT TRANSLATION OF THE QURAN INTO ALBANIAN****Abdurrahim MAXHUNI¹***1* Prishtina Institute of Albanology***Corresponding author e-mail: amaxhuni44@hotmail.com***Abstract**

The tradition of translating the Quran into Albanian language is belated, although its presence is early. The Quran was not translated until 1921, and there were several reasons for this. The National Renaissance Period gave impetus, inter alia, to the translation of the Quran into Albanian language. Although, one would expect its translation to come from the ranks of the Islamic religious community, it was translated by an Orthodox Albanian, called Ilo Qafëzezi. It was only 15 years later that an Albanian intellectual, Hafiz Ali Korça, who took the initiative to translate the Quran, including Hafiz Ibrahim Dalliu, to continue with other additional translations after almost half a century. In this conference paper, we will focus on the translation of the Quran into Albanian language and some issues concerning the target language of the translation.

Keywords: Translation, Quran, Albanian language, Qafëzezi, Korça.

Përmbledhje

Tradita e përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe është e vonë, ndonëse prezenca e tij është e hershme. Kurani nuk u përkthye deri në vitin 1921 dhe për këtë ishin disa arsye. Periudha e Rilindjes Kombëtare i tha shtysë përveç tjerash edhe përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe. Edhe pse përkthimi i tij do të pritej nga radhët e komunitetit fetar islam, ai u përkthye nga një ortodoks shqiptar, Ilo Qafëzezi. Vetëm 15 vjet më vonë, nismën për përkthimin e Kuranit e mori Hafiz Ali Korça, një intelektual shqiptar, e Hafiz Ibrahim Dalliu, për të vazhduar edhe me përkthime të tjera pas gati gjysmë shekulli. Në këtë kumtesë, do të ndalemi tek përkthimi i Kuranit në gjuhën shqipe, në veçanti ai i Qafëzezit dhe te përkthimi i Korçës.

Fjalët kyçe: Përkthim, Kuran, gjuhë shqipe, Qafëzezi, Korça.

Hyrje

Tradita islame në hapësirat shqiptare tashmë është e gjatë dhe e begatshme. Islami është mëshiruar dhe ka jetuar në mesin e shqiptarëve tash e sa shekuj. Ai ka jetuar edhe në institucionet arsimore: në medrese, mejtepe e shkolla të veçanta nga ku kanë dalë edhe shumë figura të shquara kombëtare. Mirëpo, është e mangët dhe e vonshme tradita e shkrimeve fetare në gjuhën shqipe, duke përfshirë edhe përkthimin e Kuranit, ndonëse kjo duhet të shihet në rrethanat historike e kulturore në të cilën kanë jetuar shqiptarët.

Mungesa e përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe mund të lidhet edhe me atë që Qafëzezi e thotë “*I shpërhodha ato që thonë disa se të përkthyerit e Kuranit në gjuhë tjetër është gjynah i math*”.⁴⁵⁵ Andaj shtysa, siç shprehet studiuesi Lloshi⁴⁵⁶, për ta përkthyer Kuranin shqip do të vinte jo nga kërkesat e praktikës së përditshme fetare, por nga kërkesat e kulturës më të ngritur. Periudha e Rilindjes Kombëtare i dha një shtysë të fortë gjuhës dhe shkrimit shqip, duke bërë përpjekje që shqipen ta pastronin dhe në të njëjtën kohë ta pasuronin me fjalë burimore shqipe, të mbledhur nga goja e popullit dhe duke krijuar neologjizma.

Përveç ngritjes së vetëdijes kombëtare, u shtuan përpjekjet për njësimin e alfabetit dhe nxjerrjes së ortografisë, duke vendosur rregullat e të shkruarit shqip, me të cilat synohej të dilej nga mendësia lokaliste e krahinoriste që shqiptarët të bëheshin një edhe në gjuhë. Kështu, një ndër autorët e kësaj periudhe është edhe Ilo Mitkë Qafëzezi (1882-1964). Ky autor u mor me çështje të ndryshme politike, kulturore, historike e letrare. Ilo Mitkë Qafëzezi ishte i pari që e përktheu Kuranin në gjuhën shqipe, i cili nuk ishte mysliman, por shqiptar ortodoks. Përkthimin e tij e bazoi në versionin e përkthyer të anglishtes, sepse nuk e njihte arabishten. Ai e përktheu në dy pjesë. Pjesën e parë e botoi më 1921 në Polesh të Rumanisë, ndërsa të dytën më 1927 në Korçë.

Fillet e përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe i gjejmë vetëm në fillim të shekullit XX. Programi i Rilindjes Kombëtare që aq i fuqishëm saqë krijoi kushte të mira edhe për ta përkthyer Kuranin në gjuhën shqipe. Deri në fillim të shekullit XX nevoja për përkthimin e Kuranit nuk konsiderohej e nevojshme, sepse kishte nga fetarët e kohës, të cilët mendonin se përkthimi i tij në gjuhë të tjera është i pamundur, sepse në këtë rast shqipja nuk kishte pasuri të madhe gjuhësore për të pasqyruar gjithë terminologjinë kuranore dhe me rastin e përkthimit do të mund të devijonte nga mesazhi kryesor që e jepte gjuha e Kuranit. Këtë e kishin kuptuar rilindësit, të cilët ishin edhe nismëtarë të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe.

Arsye tjetër, mendoj se pjesërisht qëndron, ishte gjendja kulturore e shqiptarëve. Shumica e popullatës ishte analfabete që nuk dinte shkrim-lexim. Duke u nisur nga kjo nuk kishte një kërkesë të përgjithshme për ta lexuar edhe në gjuhën shqipe, andaj mjaftoheshin me shpjegimet që i merrnin nga hoxhallarët e asaj kohe. Duke e parë nevojën e përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe, nga njohës të gjuhës arabe dhe njohës të fesë islame, Hafiz Ali Korça, filloi të botonte pjesë të përkthyer të Kuranit më 1926, në revistën “Zani i Naltë”. Kështu në titullin “Thelbi i Kuranit”⁴⁵⁷, të cilat i quan kuptim të disa kaptinave filloi ta përkthente.

Aty shprehej: “Zani i Naltë” qysh me këtë numur do të fillojë me botue kuptimin e disa kaptinave të shkurta të Kur-anit nën titullin “Thelbi i Kur-anit” tue ndjekun rendin, mbas të cilit janë kumtue këto kaptina. Me këtë mënyrë shpresojmë se të dashunit lexuës do të kuptojnë me lehtësi veprën e madhe të HAZRETI MUHAMMEDIT ALEJHISSELAM.”⁴⁵⁸ Nga viti 1929-1942, traditën e përkthimit e ndoqi edhe Hafiz Ibrahim Dalliu, i cili botoi tri vëllime nën titullin “Ajka e kuptimeve të Kur’anit Kerimit”. Komuniteti Mysliman Shqiptar, për herë të parë përktheu Kuranin në gjuhën shqipe më 1940, nga një komision shqiptar, njerëz që e njihnin fenë islame, por rrethanat që u krijuan pas Luftës së Dytë Botërore nuk lejuan botimin e tij.

Duke u përballur me regjimin komunist në Shqipëri, mundësitë për përkthimin e Kuranit ishin të pamundura. Kështu përkthimi i tij i plotë nga njohës të gjuhës arabe e të përgatitur u realizua vetëm në vitin 1985, në Kosovë, nga Feti Mehdiu. Shumë shpejt Kurani u përkthye edhe nga dy autorë të tjerë, nga Hasan Nahi, më 1988, po ashtu në Prishtinë dhe nga Sherif Ahmetit, më 1988. Botimi i parë i këtij të fundit u bë në Prishtinë, ndërsa u ribotua në Romë më 1990, në Kajro më 1992, dhe në Islamabad më 1993.

⁴⁵⁵ Ilo M. Qafëzezi, *Kurani (këndimi)*, Rumani, 1921, f. 3.

⁴⁵⁶ Xhevat Lloshi, *Shkrime rreth përkthimit*, Shkup, 2021, f. 129.

⁴⁵⁷ Ali Korça, “Thelbi i Kur-anit”, në revistën: “Zani i Naltë”, Tiranë, 1934, prillë-majë, nr. 8-9, f. 374.

⁴⁵⁸ Po aty, f. 374.

Ilo Mitkë Qafëzezi në parathënien e përkthimit të tij e shpreh qëllimin që e kishte shtyrë të përkthente Kuranin: “I shtyjtur prej dëshirës që, tani pak-së-paku, është koha të dihet se cila është ajo cipë qepe misterioze që i ndan fetarisht Shqipëtarët Muhamedanë nga vëllezërit e tyre të Krështerë, po jap të përkthyer Shqip Kuranin, nga gjuha Inglize – përkthim nga Arabishtja prej s. George Sales, transllator i shprovuar i Këndimit Hyjnor.”⁴⁵⁹ Qafëzezi ishte i bindur se përkthimit i tij ishte përcjellë me të meta, sepse nuk ishte bërë përkthimi drejtpërdrejt nga arabishtja, por nga anglishtja, të meta për të cilat thotë se shpreson se do t’i falen nga shqiptarët atdhetar e jo fanatikë fetarë. Sipas tij ky përkthim do të jetë një ndihmesë për teologët që do të kenë fatin e bardhë të përkthejnë Kuranin nga arabishtja.

Idetë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare ishte shtrirë në Shqipëri dhe jashtë saj, duke depërtuar thellë në mendësinë e elitës intelektuale të kohës. Në aspektin gjuhësor, mision i tyre, përveç zhvillimit të shqipes, ishte edhe pastrimin i saj nga elementet e huaja. Fusha e letërsisë shpërtheu me zhanre të ndryshme letrare, gramatikat e fjalorët e parë filluan të shihnin dritën e botimit, u njësua alfabeti dhe shumë çështje të tjera gjuhësore u trajtuan, duke u botuar edhe shumë libra. Shumë fjalë të gurrës popullore zunë vend në shkrimet e tyre, fjalori i shqipes u pasurua dhe shumë fjalë që kishin pasur përdorime të ngushta, morën statusin e mbarë shqipes.

Megjithatë, çështja e pastrimit të gjuhës nga elementet e huaja, shumë rilindës i çoi drejt purizmit, duke u munduar që çdo fjalë të huaj ta largonin nga shqipja, gjë që ishte e pamundur edhe për shumë gjuhë të tjera të mëdha e me traditë, e lere më për shqipen, e cila kishte një traditë shkrimore shumë të vonshme, e një leksik të varfër. Duke e parë pjesën e parë të përkthimit të Qafëzezit, mendoj se idetë këto ide kanë zënë vend edhe në këtë përkthim. Është e njohur se gjuha e Kuranit është një terminologji specifike, e cila nuk ndryshon. Andaj terminologjia duhet të jetë sa më afër kuptimit origjinal, sepse në shumicën e rasteve thuhet është i pamundur përkthimi i saj. Kështu, termat *abdes*, *hoxhë*, *haxhi*, *Kuran*, *xhenet*, *xhehenem* etj., nëse tentojmë t’i përkthejmë atëherë kuptimin që e bartin do t’ua zbehim.

Qafëzezi gjatë përkthimit të tij u ka ikur termave specifike islamë, duke i zëvendësuar me fjalë shqipe, e fjalë greke e latine që kanë hyrë herët në gjuhën shqipe. Kështu, në fillim të çdo sureje ai nuk ka përdorur emrin *Allah*, i cili është në të gjitha përkthimet e mëvonshme, por ka përdorur *Perëndi*: *Ndë emër të fort mëshirëplotit Perëndi*. Emrin *Allah*, i cili është i përmendur në ajete të caktuara, çdo herë e ka zëvendësuar me *Perëndi*. Krahas emrit *Perëndi* ka përdorur edhe emrin *Zot*. Termit *zekat*, iu ka referuar si *lëmoshë*: *përndajnë lëmosha* (për japin *zekatin*), sikurse edhe termin *namaz* e ka zëvendësuar me *kohët e caktuara të faljes*, *falje*, termin *xhenet* e ka zëvendësuar me *parajsë e shtet i lumturisë*, për *xhehenem* ka përdorur *skëterre* dhe *ferr*.

Por ka përdorur *relevantë* për *shpallje*. Shpesh autori ka përkthyer i ndikuar nga krishterimi, si: *birit të Marisë*, *pat dërguar hiret e tija*, ka përdorur *apostuj* për *pejgamber* etj. Me vlerë të veçantë në këtë përkthim del leksiku, i cili është mjaft i pasur me një larmi të madhe fjalësh me një paraqitje të gjallë. Ndeshin këtu të gjitha shtresat e leksikut, por dominojnë fjalët dhe format e toskërishtes. Gjuha e përdorur është një toskërishte e vjetër me shumë fjalë që nuk gjallojnë sot në shqipe, si: *hamësie* – *dëshire*, *gjurmëronç* – *pranosh*, *e kanunshme* – *e lejuar*, *kuvendesë* – *besë*, *falesim* – *haxh*, *gjaksi* – *mëkat*, *shlijësi* – *magji*, *gjërinjve* – *të afërmve* etj., ose që dëgjohen aty-këtu në të folmen e brezit të vjetër, si: *grishuar* – *prerë*, *fajtuar* – *mëkat*, *pikasin* – *vënë re*, *piqen* – *takojnë*, *nema* – *mallkimi*, *paqoj* – *pastroj*, *mba-vesh* – *dëgjon*, *mëni* – *hidhërim* etj. Nga ky këndvështrim përkthimi del me mjaft interes edhe për fjalët dialektore që ka përdorur autori, si: *çap* – *hap*, *amel-zija* – *egoizmi*, *përunjemi* – *dorëzuar*, *qësendisim* – *tallemi*, *gatej* – *krijoi* etj.

Thuhet në përgjithësi Qafëzezi ka përdorur pak fjalë që njihen si huazime, duke përdorur mundësitë e shqipes për përkthimin e Kuranit. Ai shfrytëzoi gjerësisht pasurinë leksikore të shqipes, futi në përdorim fjalë të ligjërit popullore e dialektor, fjalë të dialektit e fjalë të

⁴⁵⁹ Ilo Mitkë Qafëzezi, *Kurani (këndimi)*, Rumani, 1921, f. 3.

vendlindjes së tij, gjallëroi një numër fjalësh të vjetruara, zgjeroi semantikisht shumë fjalë, si dhe krijoi shumë fjalë të reja sipas gjedheve të shqipes.

Shembujt të tjerë leksikut të tij të pasur mund të përmendim: *grishuar – prerë, lypanjarëvet – lypsarë, shgjakësim – hakmarrje, kuvendesë – besë, terjasje – sprovë, lakërishta – perime, nema – mallkimi, mëni – hidhërim, qësendisim – tallemi, vetë-dashje – vullnetarisht, nëmosin- mallkojnë, gjaksi – mëkat, çivosur – vulosur, mbroth – të shpëtuar, ditën e mbrapme – botën tjetër, koruptoj – turbullira, llamburis – vetëton, të papërlyeme – të pastra, parabollë – shembull, pshehtësiat – të fshehtat, maqeluan – therur, dagëdis – bët keq, besë-liqtë – mizor, bini nër ment – përkujtojeni, cfilisi – dënoi, faje – mëkate, hosten – shkop, indulgjenca – mirësia, soj – lloj, kllisni – tregoni, ngas – prek, shkripturë – libër, shlijësi – magji, ditë e ngjalljes – ditë e gjykimit, faq – anë, tekdo-qenëshm – i gjerë, gjurmëronç – pranosh, mirëbërjen – dhuntinë, hirësuar – dhuruar, lerjasi – sprovoi, pa-nomëtit – mizorët, përqarkin – sillen, mbë-gjunjen – gjunjëzohen, qësendisim – tallemi, gatej – krijoi, dëshmonjës – dëshmitar, përanë - tjetër, përveç, përunjëshmë, mysliman, të nënshtruar, dorëzuar, përunjemi – dorëzuar, mba-vesh – dëgjon, udhëheq – udhëzon, nërmjetonjës – i drejtë, njeridashës – i butë me njerëz, besëliq – i padrejtë, paligjësira – mizori, këmbyerje – ndërrim, lundra – anije, përmortur – vdekur, perëndi-drojë - dashuri për Zotin, gjurmonjës – prirës, prijatar, gjurmëronjësit – pasuesit, omëshme – lejuar, çap – hap, sheshit – i hapur, keqësi – të bëni keq, ligësi – turpëri, marrëzi, gjurmoni – pasoni, fajtuar – mëkat, hamësie – dëshire, ndjesë-fajesh – falje, shpëtim, ndjesë-mëkatesh – lehtësim, jetë - ekzistencë, kamje – pasuri, me-dhiatë - testament, i vobegët – i varfër, rrobë - mbuloj, prehje, andrallosur – dhimbje koke, therorë - kurban, faleshim – haxh, gjaksi – mëkat, çprishje – çrregullm, shtrofk – vendbanim, të ardhurit – udhëtarët, fal-faje- falje, mirë-kqyrje – kujdes, ormisur – shpërblim kurore, pajë etj.*

Fjalëformimi zë vend të rëndësishëm në pasurimin e leksikut me krijimin e fjalëve të reja nga brumi i shqipes. Qafëzezi ka përdorur mjeshtërisht këtë brumë të shqipes, duke e pasuruar gjuhën e tij me ndajshesa, përngjitje e kompozim. Kështu, ai ka përdorur mjaft krijime të tilla të cilat bartin vlera të veçanta dhe tepër të gjalla, si: *udhëhiqna, jashtë-udhës, udhë-rrëfenjë, udhëhequr, (të) pa-mëntit, (të) paudhët, pa-ligjësinë, fitim-plottë, drejtazi, (të) pa-besëtit, përfill, andezaj, i gjithë-fuqishëm, shumëfarësh, të pa-përlyeme, parabollë, çvlerëshm, marin-vesh, përçajinë, zë-vendës, i gjithë-dijshëm, të pa-besëvet, mëkat-falës, mëshirë-plot, faje-falës, besë-liqtë, padretjtësisht, ndërkyren, pa-fjalë, besë-mirët, zë-dhënje, shumë-vjetshe, udhë-hiqemi, e pa-dobëtuar, e pa-ndjekur, besë-drejtët, të pa-dijshëm, për-jetë, e pa-nomëshme, pa-rrethprera, pabesëtit, shpërfaq, përripër, mbani-vesh, mosbesim, besëdrejtë, keqbërës, të lakmuarshëm, besë-plotët, paligjëvet, kurdo-herë, mos-besonjës, as-njeri, as-kujt, pa-masë, mirë-bamës, i gjith-fuqishëm, as-ndojë, pabesëri, amel-zija, afër-mëntsh, as-kush, as-gjë, i tekdo-qenëshëm, përanë, mirëbërje, pa-nomëtit, përqarkin, zemër-gjerësi, mëshirëplot, të përunjëshmë, përunjemi, besë-drejtit, njeridashës, besë-ligjtë, paligjësira, të duruarshmit, vetë-dashje, ringjallur, e përmotur, perëndi-drojë, pas-gjurmuan, keqësi, drejtas, mëshirë-plot, ndjesë-fajesh, shpërblerjen, shgjakësimi, ndjesë-mëkatash, me-dhiatë, drejtërisht, fatbardhë, gjë-sendi, darovë-math, pa-masë, e urrejtëshme, kësifarësh, fatkeqëronjë, vashë-shërbëtore, fal-faje, frikë-perëndie, besëmirësisë, pa-pushuar, dhuratë-math, vërë-gojë, i përprishur, punë-mirë, çquhet etj.*

Karakteristikë tjetër e përkthimit të Qafëzezit është edhe mënyra e veçantë e përdorimit të gjuhës. Larmia e mjeteve shprehëse e stilistike, lidhjet e reja të fjalëve, përftesat e reja, fjalëkrijimet e shumta, kanë bërë që përkthimi i tij të ketë një natyrë tejet origjinale:

perëndia është njeridashës për: Zoti është shumë i butë për njerëzit. mos çapi pas çapave të shejtanit për: mos shkoni hapave të shejtanit. ...edhe telat e marëdhëniavet ndërmjet tyre do-të priten, për: do t'i këpusin lidhjet me ta.edhe do-t' u mbesë mallëkimi për gjithmonë; dënimi i tyre nuk do-të lehtësonet, edhe as që do-të përfillen, për: aty janë përgjithmonë, dhe dënimi as u lehtësohet e as afat u lejohet këta janë ata që kanë shitur rrugë-të-drejtë për lajthim, edhe

ndjesë-fajesh për dënim, për: ata janë që kanë blerë humbjen për rrugë të drejtë edhe dënimin për falje.

Ndërsa, Hafiz Ali Korça e filloi përkthimin e Kuranit me suren e parë, e cila edhe sot e mban këtë renditje, të cilën e emërtoi *kaptina e fatihaës*. Në përkthimet e tjera të Kuranit, kjo sure emërtohet *suretu el-Fatiha*⁴⁶⁰, *sureja el-Fatiha-hyrja*⁴⁶¹, ndërsa Qafëzezi e emërton *ndërhyrje (fatihat)* etj. Siç mund të shohim, vetëm në emërtimin e kësaj sureje i kemi katër forma të ndryshme. Gjatë përkthimit të kësaj sure, Korça përdoret dy herë termin *All-llah*, të ndarë me vizë në mes dhe dy herë termin *Zot*. Qafëzezi një herë përdor *Perëndi* dhe një herë *Zotë*; Mehdiu përdor dy herë *All-llah* dhe një herë *Zot*; Sherifi përdor dy herë *Allah* dhe një herë *Zot*.

Versioni i përkthyer nga Korça në revistën “Zani i Naltë”⁴⁶² është ky: Kaptina e Fatihaës 1 – Po filloj me këndue Kur-anin tue thënë emnin e naltë të All-llahut Mëshirë-shumë e Përdëllenjës i Madh. 2- Çdo lavdërim i përket vetëm All-llahut, qi është Zoti i gjithësisë; 3 – Mëshirë-shumë e Përdëllenjës i Madhë 4 – I Zoti i ditës së Gjyqit të Amshueshëm. 5 – (Të gjitha këto cilësi e pushtede të nalta T’i njofim o Perëndi, prandaj) vetëm Ty të falemi e vetëm Ty të kërkojmë ndihmë. 6 – Na drejto në rrugën e mbarëë 7. – në rrugën e atyne, të cilëve i u ke dhanë shumë të miraë e jo në rrugën e atyne qi i morre në gazebe, as në rrugën e atyne qi rrëshqitën.

Po të bëjmë një krahasim me përkthimet e tjera, do të shohim se ka pak dallim në përzgjedhjen e fjalëve. Ndërhyrje (Fatihat)⁴⁶³ Ndër emër të fort mëshirëplotit perëndi (këtë fjali Qafëzezi e ka dhënë me fusnotë në fund të faqes, duke treguar se e ka përkthyer nga besm ullah elrohman el rahim)

1. Lavdi i kjoftë Perëndisë; Zoti i gjithë Krijetyravet.
2. Fort mëshirëploti;
3. Mbreti i ditës së gjyqit.
4. Ty të adhurojmë, edhe prej teje lypim ndihmë.
5. Udhë-hiqna ndë rrugën e drejtë.
6. Ndë rrugën e atyre mbë të cilët ke qenë hirëplot;
7. Jo ndë (rrugën) të atyre kundër të cilëve ke marë mëri, as ndë të atyre që ecëjn jashtë-udhës.

Ndërsa në përkthimin e Mehiut, të vitit 2015 pasqyrohet:
Sūreja al-Fātiha- Hyrja⁴⁶⁴

Në emër të All-llahu, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Lavdërimi është për All-llahun, Zoti i botëve,
2. Të Gjithëmëshirshmin, Mëshirëplotin,
3. Sunduesin e Ditës së gjykimit,
4. Vetëm Ty të adhurojmë, dhe vetëm nga Ti ndihmë kërkojmë,
5. Drejtona në rrugën e drejtë,
6. Në rrugën e atyre, të cilët i bekove, jo të atyre që meritojnë hidhërimin, e as të atyre që kanë humbur!

Ajo që është interesante në këto përkthime është paraqitja e hapjes së çdo sureje, që zakonisht përkthehet *në emër të All-llahu, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit*, të cilën Korça e ka pasqyruar me numër rendor, e që nuk del te përkthimet e tjera, *në emnin e naltë të All-llahut Mëshirë-shumë e Përdëllenjës i Madh*. Qafëzezi e përkthen *ndë emër të fort mëshirëplotit Perëndi*, ndërsa Mehdiu *në emër të All-llahu, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit*.

⁴⁶⁰ Sherif Ahmeti, *Kur'an-i*, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Prishtinë, 1988, f. 27.

⁴⁶¹ Feti Mehdiu, *Kur'an-i Kerim*, Prishtinë, 2015, f. 9.

⁴⁶² Ali Korça, “*Thelbi i Kur-anit*”, në revistën: “Zani i Naltë”, Tiranë, 1934, prillë-majë, nr. 8-9, f. 374.

⁴⁶³ Ilo Mitkë Qafëzezi, *Kurani (këndimi)*, Rumani, 1921, f. 5.

⁴⁶⁴ Feti Mehdiu, *Kur'an-i Kerim*, Prishtinë, 2015, f. 9.

Hafiz Ali Korça, në numrat e tjerë të “Zani i Naltë” vijon me përkthimin e pjesëve të Kuranit. Po në nr. 8-9, përkthen: kaptinën e Alek-ut, kaptinën e Nun-it, pastaj në numrat e tjerë kaptinën Muzemmil, kaptinën El Muddeththir, kaptinën Mesed e Tekvir si dhe kaptinën e Teqvirit. Ndonëse, suret të cilat i ka përkthyer në gjuhën shqipe janë të shkurtra, termat të cilat i ka përdorur sillen rreth 15 të tillë për çdo sure. Disa i ka përdorur me prejardhje orientale, disa të tjerë me prejardhje neolatine e shqipe. Kështu, Korça ka përdorur *mëshir-shumë, Perdëllenjës i Madh, falet, skëterë, mëkat, paraajs, të falmen, fe, engjëll, mëshiruës i Madh, bamirës*. Për t’iu referuar Zotit, kryesisht në fillimin e çdo sureje ka përdorur *mëshir-shumë, Perdëllenjës i Madh, mëshiruës i Madh, bamirës*. Gjuha të cilën e ka përdorur Korça për ta përkthyer Kuranin, është mjaft e qartë, me shumë elemente dialektore dhe shumë e rëndësishme për fjalët e vjetra shqipe, shumë nga të cilat nuk dëgjohen më.

Në vend të përfundimit

Ndonëse përkthyesi e ka stilin e tij vetjak, pra deri diku ka një liri në përkthimin e tij, fusha të caktuara të dijës kërkojnë më tepër saktësi dhe ngushtojnë rrugën e stileve të veçanta, por nëse marrim në konsideratë rrethanat dhe kohën e përkthimit, pavarësisht mangësive që ka, rëndësia e këtij përkthimi është e madhe, si në aspektin historik ashtu edhe në atë gjuhësor. Me mjaft interes në përkthimin e Qafëzezit dhe të Korçës del gjuha e përdorur, në veçanti leksiku e fjalëformimi.

Referencat

- [1]. Ahmeti Sherif, *Kur’an-i*, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Prishtinë, 1988.
- [2]. Lloshi Xhevat, *Shkrime rreth përkthimit*, Shkup, 2021.
- [3]. Korça Ali, “*Thelbi i Kur-anit*”, në revistën: “Zani i Naltë”, Tiranë, 1934, prillë-majë, nr. 8-9, f. 374.
- [4]. Mehdiu Feti, *Kur’an-i Kerim*, Prishtinë, 2015.
- [5]. Qafëzezi Ilo M., *Kurani (këndimi)*, Rumani, 1921.